



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS

Kuotat e pranimit në Universitetin e Tiranës për vitin akademik 2019-2020, transferim studimesh apo një program të dytë studimi në programe te ciklit të parë të studimeve, me kohe të plotë, janë miratuar me **Vendim Senati Akademik Nr.26 datë 18.07.2019 (Tabela 1).**

1. Kuotat dhe afatet kohore për kandidatët për transferim studimesh dhe program të dytë në ciklin e parë të studimeve, **Viti Akademik 2019-2020.**
2. Kuotat dhe afatet kohore për kandidatët nga Republika e Kosovës, kandidatët me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian, në programet e ciklit të parë të studimeve, me kohë të plotë, **Viti Akademik 2019-2020.**
3. Kuotat dhe afatet kohore për kandidatët shtetas të huaj, në programet e ciklit të parë të studimeve, me kohë të plotë, **Viti Akademik 2019-2020.**

Udhëzim Nr.17, datë 30.07.2019 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e Arsimit të Lartë”